



MARCH 7 - OPENING DAY OF THE FIRST ALBANIAN SCHOOL AND ALBANIAN TEACHER'S DAY – STRATEGY FOR IMPLEMENTING A COLLABORATIVE PROJECTⁱ

Merita Banjicaⁱⁱ

Dr.,

South East European University (SEEU),

Tetovë,

North Macedonia

Abstract:

Every historical event, whether national or international, that has a precious value for the progress of people is celebrated in every country of the world. The holiday of “March 7- Albanian Teacher’s Day” for the Albanian people is a celebration of pride because it enabled Albanians to see the light of the future “education” to progress in every field of life, to create knowledge, to reflect on work skills and to take positive attitudes towards learning innovations continuously. This event happened 138 years ago, but all Albanians proudly remember the opening of the “First Albanian National School” in Korça on March 7, 1887 and the teachers of this school. Every event starts from the ideas expressed, from the implementation of administrative procedures for opening an activity, providing the staff and to the realization of the idea with its functioning to satisfy the needs of the citizens, for whom that idea was promoted. This paper reflects an interdisciplinary research studied from several aspects such as historical aspect, social aspect, pedagogical aspect, didactic aspect and psychological aspect. In fact, in this paper, historical theory was applied to teaching practice was formulated into scientific didactic theory. The purpose of the research was focused on three objectives: The first objective focused on historical theoretical research for the creation of a paper based on secondary data for the holiday of “March 7-Opening Day of the First Albanian School - Albanian Teacher's Day” for a collaboration in the project organized by the “Center for Culture” Gostivar, Republic of North Macedonia on the occasion of this holiday. The second objective focused on applied empirical research for the implementation of this topic with a lecture and presentation in a lesson before the students of the 9th grade. The third objective focused on creativity, by encouraging the students to create poems as a sign of gratitude for the Albanian teachers on the occasion of “Albanian Teacher's Day”. **Research methods:** In this interdisciplinary research, several methods were used, such as the historical method,

ⁱ 7 MARSII - DITA E HAPJES SË SHKOLLËS SË PARË SHQIPE DHE DITA E MËSUESIT SHQIPTAR - STRATEGJIA E REALIZIMIT TË NJË PROJEKTI BASHKËPUNUES

ⁱⁱ Correspondence: email meritabanjica@yahoo.com

the interdisciplinary theoretical analysis method, the empirical experimental action method, the pedagogical method, the comparative method, the synthesizing method and the generalizing method.

Keywords: expressed idea, the opening of the first Albanian school, the creation of poems for teachers

Abstrakt:

Çdo ngjarje historike qoftë kombëtare ose ndërkombëtare, që ka një vlerë të çmuar për përparimin e njerëzve festohet në çdo vend të botës. Festa e “7 Marsit-Dita e Mësuesit Shqiptar” për popullin shqiptar është një festë krenarie se shqiptarëve ua mundësoi dritën e ardhmërisë “arsimimin” për të përparuar në çdo fushë jetësore, të krijojnë dije, të reflektojnë shkathtësi pune dhe të marrin qëndrime pozitive për të mësuarit risi në vazhdimësi. Kjo ngjarje ka ndodhur para 138 viteve, por të gjithë shqiptarët e kujtojnë me krenari hapjen e “Mësonjëtores së Parë” në Korçë më 7 Mars 1887 dhe mësuesit e kësaj shkolle. Çdo ngjarje nis nga idetë e shprehura, nga zbatimi i proceduarave administrative për hapjen e një veprimtarie, sigurimi i kuadrit dhe deri te realizimi i idejës me funksionimin e saj për t’i kënaqur nevojat e qytetarëve, për të cilët edhe është nxitur ajo ide. Ky punim pasqyron një hulumtim interdisiplinar të studiuar nga disa aspekte si aspekti historik, aspekti social, aspekti pedagogjik, aspekti didaktik dhe aspekti psikologjik. Në fakt, ky punim është zbatimi i teorisë historike në praktikë mësimore, por edhe i praktikës mësimore në teori shkencore didaktike. Qëllimi i hulumtimit ishte i përqendruar në tri objektiva: Objektiva e parë u përqendrua në hulumtim teorik historik për krijimin e një punimi të mbështetur në të dhëna dytësore për festën e “7 Marsit-Dita e Hapjes së Shkollës së Parë Shqipe - Ditës së Mësuesit Shqiptar” për një bashkëpunim në projektin e organizuar nga “Qendra për Kulturë” Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut me rastin e kësaj feste. Objektiva e dytë u përqendrua në hulumtim empirik aplikativ për zbatimin e kësaj teme me ligjëratë dhe prezentim në një orë mësimore para nxënësve të klasave të IX. Objektiva e tretë u përqendrua në krijimtari, me nxitjen e nxënësve për krijuar poezi në shenjë mirënjohjeje për mësimdhënësit shqiptarë me rastin e “Ditës së Mësuesit Shqiptar”. **Metodat e hulumtimit:** Në këtë kërkim interdisiplinar u përdorën disa metodat si metoda historike, metoda e analizës teorike interdisiplinare, metoda empirike eksperimentale aksionale, metoda pedagogjike, metoda krahasimtare, metoda sintetizuese dhe metoda përgjithësuese

Fjalët kyçe: ideja e shprehur, hapja e shkollës së parë shqipe, krijimi i poezive për mësuesit

1. Shqyrtime Teorike Historike

1.1 Hyrje

Në pjesën e parë të këtij punim ofrohen sqarime të koncepteve teorike shkencore historike për shfaqjen e idejës për qytetërimin e popullit shqiptar në vilajetet shqiptare, marrjes së lejes për hapjen e shkollës së parë shqipe, hapja e shkollës shqipe, ideali arsimor i atdhetarëve për hapjen e shkollës shqipe, kontribuesit kryesorë për funksionimin e shkollës, ideali i shkollës së sotme, dhe objektivat që duhet t'i arrijnë nxënësit e sotëm në shkollat fillore. Në e vijim pasqyrohen mirënjohjet, falënderimet dhe urimet e nxënësve për mësimdhënësit e tyre për rastin e festës së 7 Marsit-Dita e Mësuesit Shqiptar. Në pjesën e dytë ofrohet metodologjia e hulumtimit. Në pjesën e tretë pasqyrohet një skenar i përgatitjes ditore për procesin e mësimdhënies. Në pjesën e pestë pasqyrohen përfundimi dhe rekomandimet.

1.1.1 Ideja për hapjen e shkollës shqipe është ahprehur në Mexhilisin Osman, ndërsa vendimi është miratuar në Lidhjen e Prizrenit

Abdyl bej Frashëri, deputet shqiptar i Janinës në Mexhilisin (Parlamentin) Osman në dhjetor të vitit 1877 në Mexhilisin Osman kishte paraqitur një raport të detajuar mbi reformën në arsim, ku theksin kryesor e kishte përqendruar tek shkalla e ulët e arsimit në tokat shqiptare dhe te domosdoshmëria e hartimit të një politike të përgjithshme arsimore, që popullsia shqiptare të mund të shkollohej dhe të arrinte në një nivel të caktuar qytetërimi.ⁱⁱⁱ Ky raport kishte ndikuar tek deputetët tjerë për ngritjen e kulturës së qytetërimin me përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla.

Njëra nga ngjarjet më të rëndësishme të krijimit të shtetit dhe të bashkimit të kombit shqiptar është Lidhja e Prizrenit (turqisht : *Prizren Itifaki ose Ittihadi*), që ka qenë një organizim politik i parisë së katër vilajeteve të shumicës shqiptare të popullsisë të Perandorisë Osmane, që është themeluar zyrtarisht më 10 qershor 1878 në Xhaminë Bajraklie të Prizrenit. Ky qytet para një viti kishte qenë qendra e Vilajetit të Kosovës.

Në Lidhjen e Prizrenit në seancën e parë më 10 qershor 1878 është propozuar, që katër vilajetet shqiptare (Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Janinës, Vilajeti i Manastirit dhe Vilajeti i Kosovës, me qendër në Prizren) të bashkoheshin në një vilajet shqiptar autonom^{iv}.

ⁱⁱⁱ <https://telegrafi.com/roli-historik-lidhjes-se-prizrenit-1878-1881/>

^{iv} https://sq.wikipedia.org/wiki/Lidhja_e_Prizrenit_10_qershor_1878



Figura 1: Objekti ku u mbajt Lidhja e Prizrenit dhe u shpreh ideja për hapjen e shkollave shqipe

Diskutimi për idejën e shfaqur në seancën e parë për bashkimin të vilajeteve ka vazhduar në seancën e dytë më 18 qershor 1878, ku janë reflektuar qëndrime të ndryshme, që janë shkruar në pesë vendime në dokumentin “*Kararnamé*”, që është nënshkruar nga 47 përfaqësues të kazave të vilajetit. Nënshkruesit e parë kanë qenë *Iljaz pashë Dibra* dhe *Abdullah pashë Dreni*.

Elita shqiptare që kishte qenë pjesë aktive e jetës politike dhe kulturore në Stamboll si vëllezërit Frashëri (Abdyli, Naimi, Samiu) dhe të tjerë, e kishin hartuar platformën e parë politike shqiptare e titulluar “*Program autonomie për vilajetet e banuara nga shqiptarë*” që është botuar më 27 shtator 1878 në gazetën “*Tercüman-i Sark*” në Stamboll, ku kryeredaktor ka qenë Sami Frashëri.

Dokumenti *Kararnamé* është formuluar me këto vendime:

- vilajetet të bashkoheshin në një vilajet shqiptar autonom;
- nëpunësit që do të punonin atje të dinin gjuhën shqipe;
- dy herë në vit të mbledhej një Kuvend i Përgjithshëm i Vilajetit;
- gjuha e shkollës dhe e administratës të jetë shqipja, ndërsa turqishtja të përdorej vetëm në komunikim me pushtetin qendror;
- të krijohet një milici shqiptare për gjithë vilajetin autonom.

1.1.2 Hapja e Mësonjëtores së Korçës

Lejen nga Sulltan Abdylhamidi II për hapjen e shkollës shqiptare së parë për djem në Korçë, pas shumë përpjekjeve në vitin 1885 kishte arritur ta sigurojë Naim Frashëri, zyrtar në Ministrinë e Arsimit në Stamboll, me të vëllain, Sami Frashërin dhe shqiptarë të tjerë me ndikim të “*Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip*”. Autoritetet osmane u kishin

dhanë leje mësimdhënien ta ndiqnin vetëm fëmijët krishterë, por vendasit i kishin lejuar edhe myslimanët.

Mbështetja financiare për hapjen e shkollës ishte mundësuar nga mërgata e Rumanisë, anëtarët e Shoqërisë “Drita” të Bukureshtit , ndërsa shqiptarët e Stambollit kishin vendosur drejtor i shkollës të ishte Pandeli Sotiri , të cilin e kishin dërguar në Korçë për ta hapur shkollën. Pandeli Sotiri, pas përpjekjeje këmbëngulëse dyvjeçare, kishte arritur ta hap “Shkollën e Parë Shqipe” në Korçë më 7 mars 1887. Kjo shkollë kombëtare laike shqipe kishte filluar me punë mjedisin e shtëpisë së dhuruar nga patrioti i mërguar korçar, Diamant Terpo.^v



Figura 2: Shkolla Parë Shqipe dhe 35 nxënësit e parë të kësaj shkolle

Pandeli Sotiri mësimin e kishte filluar me 35 nxënës. Në vitin 1888, shkolla kishte pasur 100 nxënës të krishterë dhe 60 myslimanë (160 nxënës), ndërsa vitin e dytë rreth 200 nxënës. Kjo shkollë kishte funksionuar me një klasë përgatitore dhe katër klasa të rregullta. Mësues e kësaj shkolle kanë qenë: *Koço Sotiri, Petro Nini Luarasi, Thoma Avrami, Ali Korça, Nuçi Naçi.*^{vi}

Pandeli Sotiri gjatë 1887 është larguar nga Korça, ashtu që administrimi i shkollës i ka kaluar Petro Nini Luarasit dhe Thanas Sinës. Mësonjëtorja e Korçës ka funksionuar

^v https://sq.wikipedia.org/wiki/M%C3%ABsonj%C3%ABtorja_e_Kor%C3%A7%C3%ABs

^{vi} <https://portalb.mk/mesonjtorja-e-pare-shqipe-e-korces/>

15 vite, por është mbyllur në vitin 1902, përsëri është rihapur në vitin 1908, përsëri është mbyllur në vitin 1912 dhe është hapur pas pesë viteve në 1917.

Mësimi ishte zhvilluar me mësim të organizuar, kurse synimi kishte qenë arritja e dijes te çdo nxënës, prandaj ishte zhvilluar sipas kurrikulës mësimore në tetë lëndë mësimore shkencore.




Figura 3: Kurrikulla mësimore e shkollës së parë shqipe

Tekstet e shkollës i kishin përgatitur nga Naim Frashëri, Sami Frashëri, Jani Vreto dhe të tjerë. Përkrahës të shkollës kishin qenë edhe personalitete të njohura të Rilindjes Shqiptare, si: Naum Naçi, Thoma Avrami, familja Qiriazi (Gjerasim, Sevasti dhe Parashqevi) etj.

Atdhetarët vendas dhe të mërgatës i kishin siguruar pajisje për mësim, tekstet shkollore, mjete mësimdhënies dhe mjetet për nxënësit. Ndërtesa ku u hap “Shkolla e Parë Shqipe” ose “Mësonjëtorja e Korçës” sot njihet edhe me emrin Muzeu i Kombëtar i Arsimit . Ndërtesa e muzeut ka tetë mjedise ekspozimi.

1.1.3 Qëllimi i idealit arsimor i atdhetarëve për hapjen e mësonjëtores së Korçës

Qëllimi i idealit arsimor i atdhetarëve për hapjen e shkollës së parë shqipe ka qenë përhapja e dijes në popull dhe nxitja e patriotizmit, që brezat e rinj ta vazhdonin ideologjinë e mësuesve të tyre, të bëheshin luftëtarë për luftën për liri dhe pavarësi. Mësimi në këtë shkollë ishte zhvilluar në objekt shkollor, e jo nëpër shtëpi private dhe ishte zhvilluar në mënyrë të fshehtë si ishte bërë para marrjes së lejes nga Perandoria Osmane.




Figura 4: Qëllimi i idealit arsimor i atdhetarëve për hapjen e shkollës së parë shqipe

Kjo shkollë për nga karakteri në esencë kishte pasur tipare demokratike: shkollë shqiptare se mësohej në gjuhën shqipe, shkollë e pavarur se mbahej nga populli, shkollë demokratike se kishte qenë pa pagesë (ku kishin mësuar fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur), shkollë popullore se ishte hapur me dëshirën e popullit, shkollë e përgjithshme laike se lëndët ishin të bazuar në shkencë.




Figura 5: Tiparet demokratike të Mësonjëtores së Korçës

1.1.4 Vëllezërit Frashëri Kontribues Për Hapjen Dhe Funkzionimin E Mësonjëtores Së Korçës




		
Abdyl Frashëri	Naim Frashëri	Samî Frashëri
Lindi: Frashër, 1 qershor 1839 Vdiq: Stamboll, 11 tetor 1892 (53 vjeç)	Lindi: Frashër, 25 maj 1846 Vdiq: Stamboll, 20 tetor 1900) (54 vjeç)	Lindi: Frashër, 1 qershor 1850 Vdiq: Stamboll, 18 qershor, 1904 (54 vjeç)
Shprehës i idejës për arsimimin e popullit shqiptar si domosdoshmëri e qytetërimit shoqëror	E këndimit të çunave (1886) në dy pjesë –I dhe II	Abetare e gjuhës shqipe (1886)
Njëri nga udhëheqësit kryesorë i Lidhjes së Prizrenit,	Vjersha për mësonjëtoret e para (1886)	Shkronjëtoret e gjuhës shqipe (1886)
	Dituritë për mësonjëtoret e para, që përfshinë aritmetikë, gjeometri, fizikë, kimi dhe biologji (1886)	Dheshkronjë (1886)
	Istori e Shqipërisë (1886)	

Figura 6: Rilindasit që ndikuan në Parlamentin Osman për shprehjen e idejës për arsimimin e popullit shqiptar drejt qytetërimit dhe për marrjen e lejes për hapjen e shkollës së parë shqipe

Vëllezërit Frashëri kanë qenë kontribuesit më të mëdhenj, që kanë ndihmuar në funksionimin e shkollës shqipe, për shkak se vet kanë qenë të arsimuar dhe e kanë ditur vlerën e arsimit. Abdyli, Naimi dhe Samiu kanë qenë ideologët kryesorë të Rilindjes Shqiptare. Abdyli ka qenë deputet në Mexhilisin Osman, ku më dhjetor 1877 e ka shpreh

idejën për arsimim të popullit në gjuhën shqipe për të arritur qytetërimin shoqëror të domosdoshëm në atë kohë.

Ideja e tij ka ndikuar edhe në formulimin e vendimeve në dokumentin “Kararname” të miratuar në Lidhjen e Prizrenit sidomos të vendimit të dytë për përdorimin e gjuhës shqipe në administratë të vilajetit autonom shqiptar, por edhe në formulimin e vendimit të katërt për arsimimin e popullit në gjuhën shqipe nëpër shkolla dhe gjuha shqipe të përdoret në administratë për nevojat lokale, kurse turqishtja të përdoret vetëm për nevojat administrative qendrore. Naimi në atë kohë ka arritur ta marrë lejen për hapjen e “Mësonjëtores së Korçës”.

Naimi me Samiun dhe Jani Vreton i kanë shkruar librat e “Mësonjëtores së Korçës”. Samiu arsimin e kishte vlerësuar shumë prandaj në thënien e tij thotë: “Arsimi zgjon mendimin e njeriut, ndriçon mendjen e tij, rrit zgjuarësinë dhe kur ndriçohet mendja dhe rritet zgjuarësia atëherë rritet forca e tij”. Vëllezërit Frashëri kanë vdekur të ri, në moshën 53-54 vjeçe.

1.1.5 Qëllimi i idealit arsimor i shkollave të shekullit XXI

Qëllimi i idealit arsimor i shkollave tona në shekullin XXI është i përqendruar në dy objektiva:

- nxënësi të mësohet si të mësojë (krijimi i shkathtësive të punës duke punuar)
- nxënësi të mësohet si të jetojë (gjindshmëria me sfidat jetësore – të mësuarit gjatë gjithë jetës)




Figura 7: Qëllimi i idealit arsimor i shkollave të shekullit XXI

Qëllimi i mësimit mbështet në qëllimin e idealit arsimor, që arrihet përmes objektivave:

- 1) Objektiva e parë është arritja e dijeve (aftësi kognitive, shkathtësi pune dhe qëndrime pozitive për vlerat (të krijojnë virtyte e të pranojnë risi të mira , kurse t'i largojnë veset e ta largojnë të keqen) te çdo nxënës për çdo lëndë mësimore.
- 2) Objektiva e dytë është arritja e dijeve për të pasur përgjegjshmëri ndaj përgjegjësisë të obligimit si nxënës te çdo nxënës për t'i respektuar rregullat e shkollës.

- 3) Objektiva e tretë është arritja e dijeve për komunikim të çdo nxënësi për të komunikuar në gjuhën shqipe letrare dhe gjuhë të tjera për të reflektuar shkathtësitë e plurilingualizmin.
- 4) Objektiva e katërt është arritja e dijeve për socializim të çdo nxënësi për t'i reflektuar shkathtësitë e bashkëpunimit me të gjithë me respekt të ndërsjellë ndaj njëri tjetrit në një shtet demokratik multikulturor (parimi i respektimit të diversitetit multikulturor, solidaritetit, mirëkuptimit, tolerancës, empatisë etj).
- 5) Objektiva e pestë është arritja e dijeve për atdhedashuri e jo shpërngulje masive.
- 6) Objektiva gjashtë është arritja e dijeve për gatishmëri për të mësuarit gjatë gjithë jetës
- 7) Objektiva shtatë është arritja e dijeve për respektimin e Eko-Standareve të çdo nxënësi për të t'u sjellur në mënyrë të qytetëruar në hapësirë për të mirën shoqërore- vetëdijësim për respektim të Eko- Standareve në nivel lokal, rajonal dhe global.
- 8) Objektiva e tetë është arritja e dijeve të çdo nxënësi për t'i shprehur shkathtësitë e vlerësimit dhe vetëvlerësimit për punën e tyre.
- 9) Objektiva e nëntë është arritja e dijeve hulumtuese me angazhim në krijimin e projekteve, nxitja e kureshtjes të çdo nxënësi me angazhim në projekte të ndryshme.
- 10) Objektiva dhjetë është arritja e dijeve mediatike të çdo nxënësi për të kuptuar rolin e MASMEDIAS në shoqëri duke reflektuar kulturë mediatike qytetëruese duke mos e dëmtuar personalitetin e të tjerëve.
- 11) Objektiva njëmbëdhjetë është arritja e dijeve të çdo nxënësi dhe për t'i reflektuar shkathtësitë digjitale duke krijuar krijime të nevojshme për të jetuarit në shek. XXI.
- 12) Objektiva dymbëdhjetë është arritja e dijeve shëndetësore të çdo nxënësi për mbrojtje nga sëmundjet e ndryshme si obeziteti, diabeti, pandemitë, etj. me përdorimin e ushqimit të shëndetshëm, mirëmbajtjen e higjienës personale, të higjienës së mjedisit, aktivitetet fizik etj.
- 13) Objektiva trimbëdhjetë është arritja e dijeve për zhvillimin e talentit vetjak për arte të ndryshme: figurative, letrare, muzikore, pjesëmarrje në gara etj.




Figura 8: Objektivat e idealit mësimor- arsimor të shekullit XXI

1.1.6 Mirënjohtet, falenderimet dhe urimet e nxënësve për mësimdhënësit

Në vijim pasqyrohen urimet, mirënjohtet dhe falënderimet e nxënësve për punën e palodhshme të mësimdhënësve të tyre:

Mësimdhënëses sime

Mësimdhënëse e dashur, udhërrëfyesja jonë,
Me dije e dritë, na ndriçon çdo zonë.
Me fjalët e tua plot ngrohtësi
Na mëson me shumë dashuri.

Ti je prindi i dytë, që na qëndron pranë,
me durim e zemër çdo ditë pandërprerë,
Na udhëzon me fjalë të urta plot,
Na jep dritë na tregon botë.

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Esra Mustafi kl.IX/2

Mësimdhënëses sime

Ti je drita në ditët e mia,
Me fjalët e tua mbushur me dije,
Si pranvera që sjellë ngrohtësi
Me durim dhe dashuri.
Udhërrëfyesë për hapat e mi.

Në sytë e tuaja shkëlqen shpresa,
Si diell që ndriçon çdo zemër,
Me butësi dhe urtësi,
Mbjell ëndrra në shpirtin tim,
Mësuesja ime Ylli im.

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Zejnep Sejдини kl.IX/2

Mësimdhënësve të mi

Urime 7 Marsi – Dita e Mësuesit
të gjithë arsimtarëve të mi !!!
Jemi me fat që jemi nxënës të Juaj!!!

Dorart Isakur i kl. IX/1

Mësimdhënësve të mi

Mësimdhënës të dashur,
Ju na keni mësuar shumë gjëra të rëndësishme
,
jo vetëm lëndët mësimore, por edhe na keni
edukuar
si të bëhemi njerëz të mirë.

Ju na keni ndihmuar të rritemi,
na keni këshilluar si të besojmë në shkathtësitë
tona.
Ju jeni shembull i shkëlqyer për ne,
Ne ju admirojmë shumë,
Ju faleminderit për durimin dhe
përkushtimin,
që e keni reflektuar ndaj nesh .

**Të gjithë mësimdhënësve shqiptarë
Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!**

Lina Xhelili kl. IX/1

Arsimtares sime

Urime 7 Marsi – Dita e Mësuesit
arsimtare e dashur !!!
Ju falënderoj për punën dhe kontributin që e
keni dhënë për ne!!!
Jemi me fat që jemi nxënës të një arsimtareje të
mrekullueshme sikur jeni Ju !!!
Gëzuar festën!!!

Erina Beshiri kl. IX/1

Arsimtares sime

Urime 7 Marsi – Dita e Mësuesit
kujdestarja jonë e dashur !!!
Ju falënderoj për kontributin,
që e keni dhënë për ne!!!
Ky është viti i fundit i punës sonë të
përbashkët, por shpresoj se do të takohemi
edhe në të ardhmen !!! Gëzuar festën!!!

Drilon Jusufi kl. IX/1

Mësimdhënësve të mi

Çdo ditë na udhëzoni me dashuri,
Me libra , me dije, me plot urtësi .
Si prind të dytë, me zemër të pastër,
Na jepni shpresë, për një jetë më të gëzuar.

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Genc Amzi kl. IX/2

Arsimtarja ime, dritë e diturisë

Arsimtare e dashur, ëngjell i dijes,
Me fjalët e tua, hap shtigjet e shpresës.
Me zemër të madhe, me shpirt plot mirësi,
Na udhëzon drejt ëndrrave, drejt ardhmërisë.

Ti je një prind, një mik, një udhërrëfyes, Në
rrugën e gjatë të dijes së vyer,
Me ty ne rritemi, me ty ne fluturojmë,
Faleminderit për gjithçka, ty të nderojmë

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Kaltrina Zulbehari kl. IX/4

Arsimtarja ime

Arsimtarja ime, si diell më ndriçon,
Me fjalët e tua, zemrën ma ngroh.
Në rrugën e dijes, më orienton,
Si prind i dytë, me dashuri më mëson.

Me durim e butësi më udhëzon,
Çdo shkronjë, çdo fjalë me kujdes e sqaron,
Në zemrën time kujtim do të mbetesh,
Si ylli, që rrugën ma ndriçon përherë.

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Anik Xhaferi kl.IX/4

Arsimtarja ime

Arsimtare, njeri i dashur dhe i mençur,
Na ndihmon ta shohim dritën kur është
errësirë.

Me fjalët tua mirësjelljeje
Na udhëzon për çdo hap në jetë.

Ti je ylli që ndriçon rrugën tonë,
Në çdo mësim një mundësi e re për dituri,
Arsimtare falënderit për gjithçka,
për durimin, pasionin dhe dashurinë.

Dëshiroj që kjo ditë të jetë për ty,
një falënderim për çdo sakrificë
për çdo fjalë të bukur dhe çdo këshillë.

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Amra Fazlija kl.IX/4

Mësimdhënësja Ime

Mësimdhënëse e dashur, me zemër të artë
Si diell që ndriçon çdo rrugë të gjatë,
Me fjalë të ëmbla e plot mirësi,
Na udhëzon me plot dashuri.

Kur gabojmë na mëson sërish,
Si një nënë me shpirt fisnik,
Për ne lodhesh për ne mendon,
Çdo ëndërr tonë e bekon.

Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit Shqiptar!!!!

Me dashuri nga Haula Aliu kl.IX/4

Mësimdhënësve të mi

Në 7 Mars me plot nderim,
Ju falënderojmë me përkushtim .
Me dijen tuaj na ndriçoni,
Të ardhmen tonë ju e formoni.

Si prind i dytë, si dritë në jetë,
Me fjalë të arta e zemër të qetë,
Në çdo mësim një ëndërr ndizni,
Shpresat tona lart i ngjitni.

Urime 7 Marsi-Mësimdhënës të nderuar !!!!!

2. Metodologjia e Hulumtimit

Hulumtimi për këtë punim u nxit nga drejtoresha e “Qendrës për Kulturë”-Gostivar, Farije Adili dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut” me projektin për rastin e festës së “7 Marsit-Ditës së Mësuesit Shqiptar”. Në këtë projekt janë përfshirë disa mësime nga shkollat e qytetit të Gostivarit, me të cilët janë zhvilluar edhe intervista.

2.1 Mostra

Unë për këtë festë përgatita një punim, që e prezantova para nxënësve të mi në pesë paralele të IX/1, IX/2, IX/3, IX/4 IX/5 (gjithsej 98 nxënës) me anë të teknologjisë digjitale për t’u dhënë më tepër njohuri për vlerën e kësaj feste dhe për t’i nxitur nxënësit të krijojnë poezi në shenjë mirënjohjeje për mësime të tyre, të cilat i pasqyrojmë në fund të punimit. Inçizimin e orës dhe intervistën me mua si mësime të Shkollës Fillore “Ismail Qemali” Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut, e realizoi stafi i Shtëpisë Mediatiqe Televizive “TV Globi” Gostivar.

2.2 Hulumtim Empirik Aksional

Gjatë orës mësimore të zhvilluar më 20.02.2025 me nxënësit e klasave X/1, IX/2, IX/3, IX/4 IX/5 të Shkollës Fillore “Ismail Qemali”, Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut u prezantua pjesa teorike e këtij punimi dhe u angazhuan nxënësit të krijojnë poezi për mësime të tyre për “Ditën e Mësuesit”.

- Mësime të Merita Banjica
- Paralelet: IX/1, IX/2, IX/3, IX/4 IX/5, (Ky punim u prezantua te këto paralele).
- Data: 20.02.2025
- Tema: Historia e letërsisë-Periudha e Rilindjes Kombëtare
- Njësia mësimore: 7 Marsi- Dita e Hapjes së Shkollës së Parë Shqipe dhe Dita e Mësuesit Shqiptar
- Mësim i integruar: Njohuri nga lënda e gjuhës shqipe, historisë, gjeografisë, informatikës etj.
- Modeli i mësimit: Projekt hulumtues me mësime hibride
- Strategjitë mësimore:
- Metodat e punës: PNP, AIDA (shqip VIDD) i sqarojmë më poshtë.
 - 1) A (attention-vëmendja)
 - 2) I (interes-d- interesim ose kureshtje –pjesa kryesore e orës)
 - 3) D (desire- dëshira)
 - 4) A (action –nxënësit në veprim ose demonstrim)
- Paranjohtitë: Bashkëbiseduese, Stuhi mendimesh për sqarim konceptit “Ide”,
Ndërtimi: Prezantim të temës me teknologji digjitale.
- Ditari dypjesësh me pyetje strategjike 6 Përse?
- Diskutim për organizuesin grafik për objektivat mësimore –arsimore të sh. XXI
- Krijimtari: Krijimi i poezive, dërgimi i poezive dhe paraqitja e tyre në punim.

Mjete e punës: Interneti, Microsoft Word 2010, Microsoft PowerPoint 2010.

Format e punës: Frontale, në grup, individuale, tandem. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies:

- *Hapi i parë*: Përdorim i organizuesit grafik “Stuhi mendimesh “ për nxitje të shprehjes së mendimeve për sqarimin e konceptit “Ide”. Nxënësit shprehën ide të ndryshme për këtë koncept si:




Figura 9.Organizues grafik për sqarimin e konceptit ide

- *Hapi i dytë*: Prezantimi i punimit.
- *Hapi i tretë*: Diskutimi i zhvilluar me pyetje strategjike për punimin e punuar që shënohen në një ditar dypjesësh metodën pyetje qëllimore 6 Përse?

Tabela 1: Ditari dypjesësh me pyetje strategjike të nivelit të lartë të Taksonomisë së Blumit

Pyetje	Përgjigje
Përse u shfaq ideja për hapjen e shkollave shqipe?	Ideja për hapjen e shkollave u shpreh me qëllim, që populli të arsimohej për qytetërim shoqëror. Qëllimi i fshehtë ka qenë ngjallja e ndjenjës së patriotizmit dhe shfaqja e dëshirës për liri dhe pavarësi të vendit.
Përse vendimi për hapjen e shkollave u miratua në Lidhjen e Prizrenit?	Vendimi u miratua në Lidhjen e Prizrenit më 10 qershor 1878 se aty ishin të pranishëm paria e katër vilajeteve shqiptare, që aty u vendos të bashkoheshin në një vilajet të përbashkët autonom shqiptar.
Përse u vendos në administratën e vilajetit autonom të bëhej komunikimi në gjuhën shqipe, ndërsa në nivel qendror komunikimi të bëhej në gjuhën turke?	Në Lidhjen e Prizrenit u vendos komunikimi administrativ në vilajetin autonom të bëhej në gjuhën shqipe se aty banonin shqiptarë dhe të vihej gjuha e popullit në përdorim, kurse në nivel qendror të komunikoheshin në gjuhën turke se qeverisës ishte Perandoria Osmane.
Përse Naim Frashëri e siguroi lejen për hapjen e shkollës?	Naim Frashëri në atë kohë ishte Ministër i Arsimit i Qeverisë Osmane në Stamboll.
Përse drejtor i shkollës është emëruar Pandeli Sotiri?	Elita shqiptare e Stambollit kishte vendosur drejtor i shkollës të ishte Pandeli Sotiri , të cilin e kishin dërguar në Korçë për ta hapur shkollën. Ai pas dy viteve e kishte hapur shkollën , por atë vit kur shkolla kishte filluar të funksionojë ai ishte larguar, kurse administrimi i kishte kaluar Petro Nini Luarasit dhe Thanas Sinës.
Përse kjo shkollë nuk financohej nga Qeveria Osmane?	Kjo shkollë ishte shkollë laike, popullore dhe demokratike, që financohej nga populli dhe në të mësonin të gjithë nxënësit pa dallim fetar. Diamant Terpo e dhuroi shtëpinë e tij për t'u bërë shkolla, atdhetarët vendas dhe ato të mërgatës i kishin siguruar pajisjet shkollore, mjetet për mësimdhënie dhe mjetet për nxënësit, ndërsa vëllezërit Frashëri i kishin përgatitur librat.

Përse festohet 7 Marsi?	Festa e 7 Marsit festohet për nder të hapjes së “Mësonjëtores së Korçës”.
-------------------------	---------------------------------------------------------------------------

- *Hapi i katërt*: Diskutim për idealin arsimor të shkollës së shekullit XXI duke përdorur organizues grafik për klasifikimin e objektivave arsimore dhe objektivave mësimore të shekullit XXI.
- *Hapi i pestë*: Nxënësit u angazhuan të krijojnë poezi për mësimdhënësit, që m'i dërguan përmes rrjetit social “Viber” ose e-mail-it, që pasqyrohen në fund.

3. Përfundim

3.1 Aspekti Social

Qasja në bashkëpunim në dy projektet e organizuara nga partnerët lokal “Qendra për Kulturë”-Gostivar, më mundësoi t'i reflektoj përvojat mësimore, krijimet e nxënësve dhe arritjet mësimore në shekullin XXI me temat: “22 Nëntori-Roli Historiko Gjuhësorë i Kongresit të Manastirit”^{vii} dhe “7 Marsi- Dita e Hapjes së Shkollës Shqipe dhe Dita e Mësuesit Shqiptar”.

3.2 Aspekti Historik

Shfaqja e idejës për hapjen e shkollave shqipe është bërë nga Abdyl bej Frashëri në Mexhilisin Osman në dhjetor të vitit 1877, ndërsa vendimet për hapjen e shkollave shqipe janë diskutuar në 10 qershor 1878 në Lidhjen e Prizrenit, por janë shkruar në dokumentin “Kararname” në seancën e dytë të Lidhjes së Prizrenit më 18 qershor 1878. Leja për hapjen e shkollës është marrë nga Perandoria Osmane është bërë nga Naim Frashëri më 1855, kurse hapja e shkollës është bërë nga Pandeli Sotiri më 7 Mars 1887 në Korçë. Kontribuesit kryesorë kanë qenë vëllezërit Frashëri, Diamant Terpo(dhuruesi i objektit), drejtori dhe mësuesit e shkollës.

3.3 Aspekti Pedagogjik

Mësimdhënia hibride me mësim të integruar dhe mundësoi zhvillimin e mësimimit me strategji mësimore të ndryshme me ndihmën e mjeteve teknologjike digjitale duke u mundësuar nxënësve të bëjnë lidhshmëri koherente dhe kohezive të njohurive nga disa lëndë mësimore si të gjuhës shqipe, historisë, gjeografisë, informatikës. Përdorimi i teknologjisë digjitale e lehtëson punën e mësimdhënësit në klasë se i mundëson prezantim të mësimimit, demonstrim të hulumtimit në burimet e internetit, si bëhen organizues grafikë, si merren ilustrime, si bëhen dhe si dërgohen krijimet (poezi, ese etj.) me anë të e-mail-it ose me rrjeteve sociale. Nxënësit i nxit ta përqendrojnë vëmendjen në mësim, të bëhen kureshtar për të mësuar risi, të diskutojnë, të krijojnë, të prezantojnë dhe të vetëvlerësojnë punën e tyre me punën e të tjerëve.

^{vii} <https://centrum.mk/wp-content/uploads/2023/12/PJESA-16.pdf>

3.4 Aspekti Pedagogjik-didaktik

Përceptimet vizuale, auditive dhe verbale i mundësojnë çdo nxënësi njohuritë e reja t'i mbaj mend dhe t'i klasifikojë më lehtë në kujtesë, që më vonë t'i përzgjedh sipas nevojës për të krijuar dije të reja dhe duke krijuar përvojë në përditshmëri. Nxënësit i mundësohet ta zhvillojë të menduari kritik dhe krijues individual.

3.5 Aspekti Psikologjik

Përdorimi i teknologjisë në mësim nxënësit i nxit ta çmojnë më tepër vlerën e arsimimit dhe qytetërimit shoqëror.

4. Rekomandime

Hulumtimi teorik dhe pjesa empirike aksionale (vepruese) ndriçuan nevojën për pajisjen e klasave me teknologji digjitale si nevojë e domosdoshme e shekullit XXI.

- Partneriteti në bashkëpunim mundëson përparim në çdo fushë me ngritje të kulturës individuale të çdo nxënësi dhe kulturës shoqërore
- Furnizimi i klasave me mjete teknologjike digjitale e lehtëson mësimdhënien.
- Mjetet teknologjike janë më të dëshiruar për nxënësit sesa shkumësi gëlqeror, që krijon alergji, pluhur dhe lodhje fizike të krahëve dhe duarve derisa shkruhet në dërrasë të zezë.

Conflict of Interest Statement

I declare that I have worked on this paper myself to reflect the partnership in cooperation of primary school teachers with local education partners.

This paper focused on achieving several objectives:

- The first objective focused on the review of knowledge based on secondary data of historical theories for the needs of the implementation of the project of our partner "Cultural Center" Gostivar, Republic of North Macedonia.
- The second objective is to reflect the teaching methodology of this teaching unit in relation to the value of celebrating the holiday of " March 7 – The Opening Day of the First Albanian School and the Day of the Albanian Teacher".
- The third objective of this paper is to address school leaders to appreciate the value of digital technological tools for facilitating teaching and for stimulating students' curiosity to learn on websites.
- The fourth objective was the desire to publish this interdisciplinary paper to reflect that historical theory was applied in practice in the Albanian language subject, while practice was transformed into didactic theory as a teaching model.

Deklarata e Konfliktit të Interest

Deklaroj se këtë punim të e kam punuar vet për ta pasqyruar partneritetin në bashkëpunim të mësimdhënësve të shkollave fillore me partnerët lokal të arsimit.

Ky punim u përqendrua në arritjen e disa objektivave:

- Objektiva e parë u përqendrua në pasqyrimin e njohurive teorike historike të mbështetura në të dhëna dytësore për nevojat e realizimit të projektit të partnerit tonë “Qendrës për Kulturë” Gostivar , Republika e Maqedonisë së Veriut.
- Objektiva e dytë ta pasqyroj edhe metodologjinë e mësimdhënies të kësaj njësie mësimore në lidhje me vlerën e krenimit të festës së “7 Marsit – Dita e Hapjes së Shkollës së Parë Shqipe dhe Dita e Mësuesit Shqiptar”
- Objektiva e tretë i këtij punimi është t’u drejtohet udhëheqësve të shkollave ta çmojnë vlerën e mjeteve teknologjike digjitale për lehtësim të mësimdhënies dhe për nxitjen e kureshtjes së nxënësve për të mësuar në web.faqet e internetit.
- Objektiva e katërt mu shfaq dëshira për ta publikuar këtë punim interdisiplinar për të pasqyruar se teoria historike u zbatua në praktikë në lëndën e gjuhës shqipe, kurse praktika u shndërrua në teori didaktike si model mësimdhënie.

About the Author

Dr. Merita Banjica currently works in a primary school, but she never shied away from scientific research and participation in scientific conferences. She researches and writes about leadership and management in education, teaching and language. She is also a translator of the Macedonian language into the Albanian language.

Për autorin

Dr. Merita Banjica aktualisht punon në një shkollë fillore, por ajo asnjëherë nuk largua hulumtimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore. Ajo hulumton dhe shkruan për udhëheqjen dhe menaxhimin në arsim, mësimdhënien dhe për gjuhën. Gjithashtu është edhe përkthyes e gjuhës maqedonase në gjuhën shqipe. Merita i ka të publikuara disa libra dhe artikuj shkencore në: Academia.edu, Globe.Edit, Knowledge: International Journal, Interligua, Centrum, etj.

<https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/169>

<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=954395>

https://www.researchgate.net/publication/310804338_Linguistic_Diversity_And_The_Advantages_Of_Bilingualism_And_Multilingualism_In_Municipality_Of_Gostivar_Macedonia

<https://journals.indexcopernicus.com/api/file/viewByFileId/1145360>

<https://my.globeedit.com/catalog/index?layout=glutifag&page=189>

<https://www.walmart.com/ip/Q-ndrimi-i-drejtor-ve-ndaj-ndryshimeve-n-shkoll-2009-2010->

[Paperback-9786200619686/347765382](https://www.walmart.com/ip/Paperback-9786200619686/347765382)

<https://botimpex.com/index.php?p=liber&l=1914>

<http://konferenca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf>

[https://library.carolinau.edu/eds?query=%22Creative%20thinking%22&type=DE&ff\[\]=Language:macedonian](https://library.carolinau.edu/eds?query=%22Creative%20thinking%22&type=DE&ff[]=Language:macedonian)

<https://journals.indexcopernicus.com/api/file/viewByFileId/1145360>

<https://centrum.mk/wp-content/uploads/2023/12/PJESA-16.pdf>

<https://www.researchgate.net/publication/384216777> ISOGLOSAT E VARIETETEVE
GJUHESORE NE TE FOLMEN E GOSTIVARIT ISOGLOSSES OF LANGUAGE VA
RIETIES IN THE SPEECH OF GOSTIVARI

Referenca

1. Bihiku dhe të tjerë (1981). Studime për letërsinë shqiptare, AShRPSSh-IGL, Tiranë.
2. Frashëri, Kristo (1989). Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1978-1881) vëllimi I, AShRPSSh-IH, Tiranë.
3. Gosturani, Xheladin (1999). Lidhja shqiptare e Prizrenit – Koha, Tiranë.
4. Kraja, Musa (1993). Mësuesit për kombin shqiptar f.105, Toena, Tiranë.
5. Kristo, Frashëri (1979). Lidhja shqiptare e Prizrenit-Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
6. Murati, Xheladin (2024). Fuqia transformuese e arsimit. Litera Group, Shkup.
7. Murati, Xheladin (2024). Hyrje në Andragogji, Litera Academy, Tetovë.
8. Musai, Bardhyl (2014). Metodologji e mësimdhënies – Arti dhe shkenca të përgatitur nga nxënës të suksesshëm, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Botimi i dytë ISBN: 978-99927-822-2-6, Tiranë.
9. Nushi, Pajazit (2002). Psikologjia e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtinë Fq.190.
10. Rizaj, Skender (1998). Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Drita, Prizren.
11. Woolfok, Anita (2011). Educational Psychology, Eleventh edition, PEARSON, 2010 ose shqip: Psikologji edukimi, Universiteti Shtetëror i Ohajës, botuar nga QAD (CDE) ISBN:978-99956-726-7-6, Tiranë.
12. Zajazi, Tahir (2003). Metodologji e mësimdhënies dhe nxënies, Vinsent Graphic, Shkup Fq. 190.

Doracakë arsimor

1. Projekt për arsimtarët e arsimit fillor, (2009). Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin XXI, Doracak për arsimtarët e arsimit fillor -USAID në bashkëpunim me partnerët ARD (Colaburition Partenrs), Shkup.
2. Projekt për arsim fillor (2009). Praktikum për mësimdhënie dhe mësim në shekullin XXI, Doracak për arsimtarët e arsimit fillor, USAID dhe ARD idetë e ndryshojnë të jetuarit (Ideas Changing Lives), Shkup.

Burime nga internet

1. Lidhja e Prizrenit parë më 18.02.2025 në: https://sq.wikipedia.org/wiki/Lidhja_e_Prizrenit_10_qershor_1878,
2. Lidhja e Prizrenit pare më 18.02.2025 në: <https://albanianpost.com/10-qershor-1878-lidhja-shqiptare-e-prizrenit/>

3. Historia e Lidhjes së Prizrenit parë më 18.02.2025 në: <https://www.kultplus.com/libri/abdyl-frasheri-perfaqesuesi-i-idealeve-te-larta-kombetare-shqiptare/>
4. Lidhja e Prizrenit pare më 19.02.2025 në: <https://www.atdheu.com/lidhja-prizrenit.html>
5. Jeta dhe vepra e Abdyl Frashërit:Shqipëria do të bëhet nga Sejdo Harka pare më 19.02.2025 në: <https://telegرافي.com/jeta-dhe-vepra-e-abdyl-frasherit-shqiperia-te-behet/>
6. Luftërat politike dhe ideologjike, me eshtrat e vëllezërve Frashëri pare më 19.02.2025 në: <https://telegرافي.com/lufterat-politike-dhe-ideologjike-eshtrat-e-vellezerve-frasheri/>
7. Vëllezërit Frashëri: Abdyl,Naimi dhe Samiu parë më 19.02.2025 në: <https://alb-spirit.com/2022/01/31/vellezerit-frasheri-abdyl-naimi-dhe-samiu/>
8. Sami Frashëri: Njerëzit e ndershëm kalben atje ku lartësohen kriminelët parë më 19.02.2025 në: <https://observerkult.com/sami-frasheri-njerezit-e-ndershem-kalben-atje-ku-lartesohen-kriminelet/>
9. Sami Frashëri parë më 19.02.2025 në: https://www.google.com/search?q=Sami++bej+Frash%C3%ABri&sca_esv=b3202a6c776f9b4f&rlz=1C1GGRV_enMK963MK963&biw=1366&bih=651&sxsrf=AHTn8zrODno
10. Mësonjëtorja e Korçës parë më 19.02.2025 në: https://sq.wikipedia.org/wiki/M%C3%ABsonj%C3%ABtorja_e_Kor%C3%A7%C3%ABs https://uet.edu.al/images/doktoratura/Nerxhivane_Krasniqi.pdf
11. Alison Doyle (2020). Critical Thinking Definition, Skills, and Examples parë më 19.02.2025 në: <https://www.thoughtco.com/critical-thinking-definition-with-examples-2063745>
12. Graham Stanley, British Council, Barcelona (2019). Approaches to process writing parë më 19.02.2025 në: <https://www.teachingenglish.org.uk/article/approaches-process-writing>
13. Rita Palushaj (2020). Psikologji e përgjithshme, parë më 19.02.2025 në: https://www.academia.edu/24907074/Psikologji_e_pergjithshme
14. Edith Cowan University (2018) Centre for Learning and Teaching parë më 19.02.2025 në: https://intranet.ecu.edu.au/data/assets/pdf_file/0004/772249/creative-thinking.pdf
15. Banjica, Merita (2023). Roli Historiko-Gjuhësor i Kongresit të Manastirit parë më 19.02.2025 në: <https://centrum.mk/wp-content/uploads/2023/12/PJESA-16.pdf>

Creative Commons licensing terms

Author(s) will retain the copyright of their published articles agreeing that a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY 4.0) terms will be applied to their work. Under the terms of this license, no permission is required from the author(s) or publisher for members of the community to copy, distribute, transmit or adapt the article content, providing a proper, prominent and unambiguous attribution to the authors in a manner that makes clear that the materials are being reused under permission of a Creative Commons License. Views, opinions, and conclusions expressed in this research article are views, opinions, and conclusions of the author(s). Open Access Publishing Group and European Journal of Foreign Language Teaching shall not be responsible or answerable for any loss, damage, or liability caused in relation to/arising out of conflicts of interest, copyright violations, and inappropriate or inaccurate use of any kind content related or integrated into the research work. All the published works are meeting the Open Access Publishing requirements and can be freely accessed, shared, modified, distributed, and used in educational, commercial, and non-commercial purposes under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License \(CC BY 4.0\)](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/).